

Dr. Sedat Islami

Ende pa mbaruar votimi, disa media të njohura për pikëpamjet hegjemoniste ndaj Islamit si fe, nxituan të publikojnë lajme si kinse sherri i arabëve nuk u pranuar në UNESCO. Pa asnjë verifikim, shumë media kopjuan njëra tjetrën, duke bërë gabime nga më trashaniket (publikuan emra shtetesh në të dyja grupet: por dhe kundër).

Fajtorë kryesorë i gjetën shtetet arabe, të cilat i mallkuan. Pati edhe deputet që nuk u kursyen nga sharjet ndaj arabëve.

Më e keqja ishte të shihje se si publikonin listën origjinale ndërsa në tekstin e lajmit manipulonin.

A ishin verbëruar sytë apo mendja? Por, nuk janë sytë ata që verbohen. Janë zemrat në gjokse.

Në vijim po iu paraqes këto shtet arabe që u përfolën se kanë votuar kundër ndërsa puna nuk është ashtu:

Arabia Saudite - pro.

Emiratet e Bashkuara Arabe - pro.

Katari - pro.

Kuvajti - pro.

Ju lutem, mos bini pre e mediave hipokrite.

Ju lutem, mos iu besoni as atyre myslimanëve që hiqen si dashamirë të së vërtetës ndërsa janë tamam sikur qeni i tërbuar që po sjell ujë në torishtë.

All-llahu ua dhëntë hakun atyre që ia duan të keqen këtij populli dhe myslimanëve!